

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS
SEKSIONI I SHKENCAVE TË NATYRËS



Tryeza Shkencore

UJITJA NË KOSOVË
MENAXHIMI I UJËRAVE
PËR BUJQËSI TË QËNDRUESHME

Abstraktet



Këshilli organizues

Ruzhdi Pllana

Feriz Krasniqi

Bashkim Kabashi

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE
E KOSOVËS
SEKSIONI I SHKENCAVE TË NATYRËS
TRYEZA SHKENCORE
16 tetor 2014

**UJITJA NË KOSOVË - MENAXHIMI I UJËRAVE PËR
BUJQËSI TË QËNDRUESHME**

PËRMBLEDHJA E ABSTRAKTEVE

1. Bashkim Kabashi

Universiteti i Prishtinës - Fakulteti i Bujqësisë dhe i Veterinarisë

**UJITJA NË KOSOVË, ZHVILLIMI, SHTRIRJA DHE
EFEKTET E UJITJES**

Abstrakt

Ujitja në Kosovë ka një historik shumë të vjetër, disashekullorë. Ka qenë dhe është masë e domosdoshme agroteknike për rritje, zhvillim dhe rendimente të larta gati të të gjitha bimëve të cilat kultivohen në këto treva, për shkak të mungesës së reshjeve (lagështisë së tokës) gjatë muajve të vegjetacionit, sidomos gjatë atyre të verës (VI-IX).

Në këtë punim do të jepen, nga pikëpamja profesionale dhe shkencore, ecuritë e zhvillimit të kësaj dege teknike dhe agroteknike, duke përfshirë: historikun e shkurtër të ujitjes në këto troje; konditat pedo-klimatike, të cilat e kushtëzojnë ujitjen; shtrirjen kohore dhe territoriale; perspektivën me mundësitë (tokësore dhe ujore) e zgjerimit të ujitjes në territorin e Kosovës. Teknikat e ujitjes; roli i ujitjes si masë e rregullt agroteknike në zhvillimin dhe rritjen e prodhimtarisë së përgjithshme bujqësore etj.

Fjalët çelës: ujitja, agroteknika, historiku, teknikat e ujitjes.

2. Ruzhdi Pllana

Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës

KARAKTERISTIKAT AGROKLIMATIKE DHE AGROMETEOROLOGJIKE NË ZONAT E UJITJES TË TOKËS NË KOSOVË

Abstrakt

Kushtet agroklmatike dhe agrometeorologjike, si tregues të ndërveprimit ndërmjet motit dhe kulturave bujqësore, janë faktorë determinues të diversitetit të kulturave bimore dhe prodhimtarisë bujqësore. Në punim analizohen ndikimet e parametrave agroklmatikë dhe agrometeorologjikë në fushën e bujqësisë si degë ekonomik me rëndësi strategjik për vendin. Vlerat mesatare të elementeve klimatike: rrezatimi i përgjithshëm diellor, zgjatja e ndriçimit diellor, shumta e temperaturës, temperatura mesatare e ajrit, me përjashtim të reshjeve për periudhën e vegjetacionit për zonat fushore të Kosovës, trajtohen si faktorë të volitshëm ekologjikë për zhvillimin e bujqësisë intensive. Mirëpo, lëkundjet nga muaji në muaj dhe nga vitit në vit janë të theksuara dhe shfaqen si faktorë kufizues për arritjen e rendimenteve normale.

Në punim analizohen lëkundjet relative të parametrave kryesorë agroklmatikë për periudhë standarde klimatike, rastisja gjatë periudhës së vegjetacionit, përkatësisht verës, dhe reflektimi i tyre në ndërhyrjet teknike të faktorit njeri për plotësimin e lagështisë së nevojshme për stabilizimin dhe rritjen e prodhimtarisë bujqësore.

Fjalët çelës: agrometeorologji, determinues, standard klimatik, lëkundje kohore.

3. Mazllum Baraliu

Fakulteti Ekonomik, Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" Prishtinë

UJITJA DHE MENAGJIMI I UJËRAVE SIPAS LEGJISLACIONIT POZITIV NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

Abstrakt

Menagjimi i ujërave, paraqet aktivitet të rëndësishëm dhe kompleks, të veprimtarisë njerëzore, e cila është shprehje e një shumësie elementesh, faktorësh dhe procesesh, në një vend apo ambient të caktuar shoqëror. Bazat në të cilat themelohen sistemet për menaxhim të ujërave: të ujitjes dhe të shërbimeve përkatëse, janë elemente të veçorive dhe karakteristikave juridike, ekonomike, teknike, shoqërore dhe shkencore. Për zhvillim struktural të menaxhimit të ujërave, peshë dhe rëndësi të veçantë kanë segmentet (disponibiliteti, shfrytëzimi dhe mbrojtja nga ujërat), pronësia (publike, private dhe e përzier), si dhe marrëshëniet pronësore (e drejta e menaxhimit, e shfrytëzimit, e disponibilitetit dhe e fitimit të mjeteve për përmbushjen e nevojave; e përdorimit të ujit; shërbimet dhe menaxhimi (publik dhe menaxhmenti biznesor, ai korporativ dhe ai burokratik).

Në procesin, rrjedhimisht, në veprimtarinë e menaxhimit të ujërave, ndikim dhe peshë të caktuar kanë edhe rrjeti i objekteve të infrastrukturës; i sistemeve teknike, i bazës teknologjike - të predeterminuar nga faktorë të tjerë, siç janë – faktorët e natyrës teknike, ekonomike dhe organizative.

Në këtë punim bëhet fjalë për ujin, resurset ujore të Kosovës; për ujitjen dhe menaxhimin e ujërave, nëpërmjet sistemeve të ujitjes dhe me mënyra e me metoda të tjera. Në punim vëmendje kryesore dhe theks i veçantë i kushtohet, shkoqitjes elaborate të kornizës legjislative; rrjedhimisht rregullativës aktuale juridike - ligjore dhe nënligjore të Republikës së Kosovës - në sferën e ujërave; menaxhimit të tyre; përdorimit në bujqësi, industri dhe, përgjithësisht, në zhvillim të qëndrueshëm, por edhe në ngritje e rritje të mirëqenies ekonomike dhe gjithëshoqërore të qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Fjalët çelës: resursët ujore; ujitja; menaxhimi i ujërave; hidroekonomia; legjislacioni; Ligji për ujërat; ligji për ujitje.

4. Besnik Gjongecaj¹, Demë Abazi²,

¹Prof. Dr., Departamenti i Agromjedisit dhe Ekologjisë, Universiteti Bujqësor i Tiranës, Kodër Kamëz, Tiranë, Shqipëri.

²Dr. M. Sc., Kompania publike e menaxhimit të ujit “Ibër Lëpenc”, Prishtinë, Kosovë.

KUANTIFIKIMI I BURIMIT UJOR NË UJITJE TEZA TEORIKE DHE REZULTATE EKSPERIMENTALE NË FUSHËN E KOSOVËS.

Abstrakt

Kuantifikimi i madhësisë së burimit uhor të nevojshëm për t’u vënë në dispozicion të furnizimit me ujë të bimëve gjatë gjithë stinës së ujitjes mund të realizohet vetëm nëse kuantifikojmë përgjatë kohës të gjithë këta faktorë që ndikojnë mbi të: evapotranspirimi, reshjet, madhësia e kapacitetit ujëmbajtës të tokës. Nëse madhësia e secilit prej këtyre faktorëve vendoset në formën e funksionit gjatë kohës në të njëjtin bosht koordinativ, krijohet mundësia e shprehjes sasiore të bilancit uhor të një zone të caktuar dhe nëpërmjet tij, pra nëpërmjet bilancit uhor, krijohet mundësia edhe për kuantifikimin e vetë burimit uhor të nevojshëm për ujitje. Madhësia e burimit uhor të gjetur korrektohet në varësi të strukturës së bimëve të mbjella dhe të fitimit të planifikuar pas realizimit të prodhimit bujqësor në treg.

Shprehja sasiore e faktorëve që ndikojnë mbi madhësinë e burimit uhor, ka ndjekur këtë rrugë: është përcaktuar nga pikëpamja sasiore funksioni i evapotranspirimit potencial ndaj kohës dhe kjo gjë është bërë duke aplikuar modelin Penman-Monteith, i cili rekomandohet sot edhe nga FAO. Reshjet janë kuantifikuar sipas metodës klasike, ndërsa kapaciteti ujëmbajtës i tokës është përcaktuar nëpërmjet kurbave pF-lagështirë, të eksperimentuar në një tokë tipike të Fushës së Kosovës.

Modeli matematik i ndjekur për kuantifikimin e vetë burimit uhor të nevojshëm në ujitje është ai i diferencës së integraleve të caktuara, ku kufijtë e integritit janë koha e fillimit të deficitit pluviometrik (t_1) dhe koha e përfundimit të deficitit pluviometrik (t_2).

Shprehja sasiore e deficitit pluviometrik, nga ana tjetër, gjeneron edhe mundësinë e karakterizimit klimatik të zonës mbi bazë të kapacitetit të saj uhor për të prodhuar, gjë që është kryer për Fushën e Kosovës dhe, gjithashtu, do të paraqitet në këtë studim. Metoda e ndjekur në këtë rast është bazuar mbi punën origjinale të Thomthwaite.

UJI SI FAKTOR EKOLOGJIK NË PËRHAPJEN E PATOGENËVE SHKAKTARË TË SËMUNDJEVE TË BIMËVE

Abstrakt

Uji është faktor kufizues në shfaqjen e sëmundjeve të bimëve me karakter epifitotik, që vepron drejtpërdrejt në formimin, lirimimin, përhapjen e organeve të riprodhimit të patogjenëve dhe shkaktimin e infektimit të bimëve. Në kushtet tona agroekologjike janë bërë hulumtime të ndikimit të lagështisë në shfaqjen dhe përhapjen e sëmundjeve të bimëve të shkaktuara nga mikozat dhe bakteriozat. Përhapja e patogjenëve përmes ujit, në krahasim me atë të erës, është më i kufizuar. Uji ndihmon përhapjen e baktereve, të organeve të riprodhimit të patogjenëve, të micelit të kërpudhave dhe të farërave të bimëve të larta parazite. Gjatë shiut dhe ujitjes patogjenët nga vendi me infektim parësor barten në sipërfaqet me kultura të shëndosha bimë. Shiu ndihmon lirimimin e organeve të riprodhimit të kërpudhave, që më tej përhapen me anë të pikëzave në drejtim të rrjedhjes së ujit. Gjatë ujitjes nëpër tokë përhapen zoosporet e kërpudhave *Phytophthora capsici*, *Pythium* spp., *Aphanomyces* spp., sporet dhe konidet e kërpudhave *Plasmopara viticola*, *Venturia inaequalis*, *V. pirina*, *Fulvia fulvo*, etj. Disa baktere përhapen dhe shkaktajnë infektimin e bimëve në prani të ujit: *Erwinia amylovora*, *E. carotovora* pv. *carotovora*, *Pseudomonas lachrymans*, *Ps. phaseolicola*, *Ps. pisi*, *Ps. tabaci*.

Fjalët çelës: patogjenët, uji si faktor ekologjik, organet e riprodhimit të patogjenëve, bakteret patogjene.

6. Sylejman Daka

EKONOMIA UJORE-MENAXHIMI I RESURSEVE UJORE DHE SISTEMET MELIORATIVE, PËRVOJAT DHE SFIDAT

Abstrakt

Në këtë punim trajtohet problemi i ekonomisë ujore, shfrytëzimi, mbrojtja dhe mbrojtja nga ujërat e plotë me theks të veçantë të kullimit e të ujitjes së tokave bujqësore dhe rritja e rendimenteve të kulturave bujqësore. Njerëzimi tash ka arritur në atë faze zhvillimore, ku kërkesat për ujë të pastër janë të larta dhe me tendencë të rritjes së mëtejme. Sasitë e ujit janë të njëjta, ndërsa kërkesat shtohen. Pas shfrytëzimit të resurseve ujore, ka edhe ndikime direkte dhe indirekte në resurset e ujit, në zvogëlimin e tyre, sidomos duke e shkakuar ndotjen e ujit. Në punim propozohen masat për shfrytëzimin dhe ruajtjen e resurseve ujore, si dhe për ndërgjegjësimin në përdorimin e tyre. Kosova është relativisht e varfër, me rreth 1700 m³ për kokë banori . Shtrohet nevoja e avancimit të menaxhimit të resurseve ujore si imperativ i kohës.

Fjalët çelës: nevojat për ujë, resurset ujore, standardi i përdorimit, ekonomi, bujqësi.

7. Shukri Fetahu¹, Imer Rusinovci¹, Sali Aliu¹,
Artan Bekolli¹

¹Universiteti i Prishtinës – Fakulteti i Bujqësisë dhe i Veterinarisë

EFEKTET E UJITJES NË RENDIMENT TË BIOMASËS NË DISA HIBRIDE TË MISRIT VARËSISHT NGA DENDËSIA E POPULACIONIT DHE AFATIT TË MBJELLJES

Abstrakt

Thatësia si faktor abiotik, është një nga faktorët më të rëndësishëm dhe kufizues për kultivim të bimëve. Kushtet agroekologjike, teknologjia e prodhimit, diversiteti i hibrideve të misrit dhe bashkëveprimi në mes këtyre faktorëve, përcakton nivelin e rendimentit të biomasës për njësi të prodhimit. Nuk mund të ketë zhvillim të prodhimit blegtoral as dhe blegtori të përparuar, pa prodhim intensiv të misrit. Bujqësia konvencionale jep rendimente të larta dhe cilësore, por për këtë nevojiten njohuri të plota profesionale dhe institucionale.

Qëllim i hulumtimeve ishte për të përcaktuar efektin e ujitjes në rendimentin e biomasës së misrit, për hibride të ndryshme, dhe me dendësi të ndryshme të populacionit. Hulumtimet fushore janë realizuar gjatë vitit (2012 dhe 2013) në Korroticë të Epërme, Drenas, me pozicion gjeografik: N42° 35'78", E 20° 55' 93" dhe 633 metra lartësi mbidetare. Hulumtimi shumëfaktorësh i ngastrave eksperimentale fushore (NEF), ishte sipas planit të plotë të rastit në bllok (DPPRB) me tri përsëritje, sipas formulës: mënyra e kultivimit (MK-2) x Vite (V-2) x hibride (H-3) x dendësi e populacionit (D-3) x përsëritje (R-3) = 108 kombinime.

Hibridet e hulumtuara: OS-298P, NSSC-444 dhe PR34FO2, me dendësi të populacionit të bimëve: D1=7,14; D2=5,71 dhe D3=4,76 bimë m², me tretmanët me ujitje dhe pa të (T1 dhe T2). Të dhënat eksperimentale ishin subjekt i analizës së variantit (ANOVA), ndërsa sinjifikacioni u përcaktua për nivel të gjasës DMVp<005 dhe DMVp<001, me programin Mikrosoft Excell dhe Minitab-16. Janë fituar rezultate me dallime të larta sinjifikante për efektet e faktorëve të hulumtuar, përcaktues të rendimentit të biomasës së misrit g bimë⁻¹ dhe kg ha⁻¹. Hulumtimet për faktorë të veçantë dhe në bashkëveprim, mundësuan identifikimin e efektit dhe ndikimin e tyre në biomasë për njësi të prodhimit, por identifikuan edhe mënyrën dhe mundësinë e shtimit të rendimentit të biomasës së misrit, ushqim për kafshë.

Fjalët çelës: ujitje, misër, hibride, biomasa, afati i mbjelljes, rendiment.

8. Imer Rusinovci¹, Sali Aliu¹, Shukri Fetahu¹,
Peder Lombanes²

¹Universiteti Prishtinës, Fakulteti Bujqësisë & Veterinarisë, Departamenti i Prodhimit Bimor

²University of Life Science, Bioforsk Institute, Os, Norway

EFEKTI I SASISË SË RESHJEVE NË PËRMBAJTJE MINERALE TE DISA LLOJE FORAGJERE NË LOKALITETIN E PRISHTINËS

Abstrakt

Klima është faktor determinues në të shumtën e rasteve në përcaktim të fenotipit dhe gjenotipit. Bimët foragjere kanë rëndësi të veçantë në hallkën e prodhimit bimor në Kosovë, si burim i pasur me energji dhe proteina që konsumohen nga sfera animale. Objektiv kryesor i hulumtimit për periudhën dyvjeçare ishte analiza e efektit të sasisë së reshjeve (ujit) për vite konkrete në lokalitetin e Prishtinës për determinimin e përmbajtjes së materieve minerale: Al, Ca, Cu, Fe, K, Mg, Mn, Na, P, dhe Zn. Dizajni i fushave ishte sipas rastit në bllok me katër përsëritje. Të gjitha analizat janë kryer në Universitetin e shkencave të Jetës në Norvegji. Hulumtimet vërtetuan se efekti i sasisë së reshjeve në përcaktim të materieve minerale ishte sinjifikant, por variable nga viti në vit, të induktuara nga sasia e ujit. Në vitin e parë hulumtues variacion i lartë u konstatua te elementi Ca, ku dallimet krahasuar me vlerën e përgjithshme mesatare (7.64 g/kg) ishin për 0.05 g/kg për vitin e parë dhe +0.05 g/kg më shumë për vitin e dytë. Dallime sinjifikante u konstatuan edhe te përmbajtja e K, ku vlera e përgjithshme mesatare ishte 21.14 g/kg, Al (0.259 g/kg). Nga të dhënat u konstatua se dallimet ishin të kushtëzuara nga ndikimi i kushteve lokale klimatike në determinimin e përmbajtjes së materieve minerale.

Fjalët çelës: reshjet, foragjeret, dallimet, përmbajtja minerale.

9. Sali Aliu¹, Imer Rusinovci¹, Shukri Fetahu¹,
Sylë Tahirsylaj¹, Besim Zogaj²

¹Universiteti Prishtinës, Fakulteti Bujqësisë, Departamenti i Prodhimit Bimor.

²Ministria e Bujqësisë, e Pylltarisë, e Zhvillimit Rural të Kosovës.

NDIKIMI I SASISË SË RESHJEVE DHE I TEMPERATURËS NË RENDIMENTE TE DISA BIMË BUJQËSORE NË KOSOVË

Abstrakt

Drithërat (gruri, misri, elbi, thekra, tërshëra), patatja paraqesin kultura shumë të rëndësishme dhe strategjike për vendin tonë. Bazuar në disa statistika, pjesën më të madhe në strukturën e mbjelljes dominon: gruri-misri, patatja dhe, më pas, të tjerat. Në rritje të rendimentit dhe në cilësi, përveç faktorit gjenetik, ndikim të lartë ka edhe faktori agroekologjik (klima), në këtë rast reshjet (uji) dhe temperatura. Objektiv kryesor i studimit ishte analiza e strukturës së pjesëmarrjes së gjenotipit të disa bimëve bujqësore nëpër vite, në raport me sasinë e reshjeve dhe me temperaturën në disa lokalitete të Kosovës. Metoda e analizës ishte split-plot, por e bazuar mbi metodën standarde për këtë natyrë të punës. Në hulumtim janë marrë disa komuna (lokalitete) të Kosovës, gjatë viteve të ndryshme. Në varësi të kushteve agroekologjike përfshirë reshjet dhe temperatura, efektin apo ndikimin e tyre në gjenotip, në këtë rast rendimentet ishin sinjifikante dhe me dallime të konsiderueshme në varësi të lokaliteteve dhe gjenotipit. Dallimet gjithashtu ishin të shprehura dhe të interpretuara përmes diagramit të Ualterit dhe Littit.

Fjalët çelës: klima, reshjet, temperatura, gjenotipet, dallimi.

10. Justina Borici

Universiteti Bujqësor i Tiranës, Kodër Kamëz, Tiranë, Shqipëri

MENAXHIMI I QËNDRUESHËM I TOKËS BUJQËSORE

Abstrakt

Studimi është kryer në vitet 2009 - 2011, për tri komuna: Gjocaj, Shezë, Karinë dhe për Bashkinë e rrethit Peqin, si vazhdim i studimeve të kryera më parë në zona të ndryshme të vendit tonë.

Janë paraqitur rezultatet sipas objektivave, si: mbledhja e informacionit për përdorimin / mbulesë tokësore për vitin 1990 dhe 2010 dhe analiza e ndryshimeve në përdorimin e tokës bazuar në parcela, skemat ujitëse dhe kulluese sipas funksionimit, si dhe zonimi i parcelave, të cilat janë nën ujë.

Realizimi i studimit ka kaluar përmes katër (4) hallkave kryesore: 1. *ekspeditimit fushor*, që përfshin vërtetimin fushor; përcaktimin në hartë të gjendjes së rrjetit kullues dhe ujitës; zonimin e ngastrave nën ujë; marrjen e mostrave të ujit të ujitjes; 2. *analizave laboratorike*: për përcaktimin e cilësisë së ujit që përdoret për ujitje; 3. *përpunimit të të dhënave nëpërmjet përdorimit të metodave*: për përcaktimin e nevojave të bimëve për ujitje; dhe 4. *sistemimit dhe interpretimit të rezultateve si dhe hartimit të përfundimeve dhe rekomandimeve*. Studimi fushor ka qenë ekspeditiv dhe vërtetues, ku puna është përqendruar kryesisht në përcaktimin e hartave manuale të gjendjes së funksionimit të rrjetit kullues dhe ujitës, zonimit të ngastrave nën ujë si dhe marrjes së kampioneve në burimet e ujit që përdoren për ujitje. Mostrat e ujit janë marrë sipas metodikës së hartuar për këtë qëllim duke respektuar të gjitha rregullat për mënyrën e marrjes së kampionit si dhe për vendin (në burimin kryesor dhe në rrjetin shpërndarës). Puna analitike ka konsistuar në përpunimin dhe në analizën e mostrave të ujit në laboratorin analitik të QTTB-së. Kampionet e ujit janë analizuar për të vlerësuar cilësinë e ujit të ujitjes.

Rezultatet e analizave janë sistemuar sipas qëllimit të studimit dhe janë krahasuar me nivelet e konsideruara “kritike”, duke bërë vlerësimet përkatëse në aspektin e vlerësimit të cilësisë së ujit, që përdoret për ujitje në këto zona. Mbi këtë bazë janë dhënë gjykimet përfundimtare dhe rekomandimet përkatëse në ndihmë të organeve që mund të kontribuojnë në përmirësimin e gjendjes së krijuar.

11. Bashkim Kabashi

Universiteti i Prishtinës – Fakulteti i Bujqësisë dhe i Veterinarisë

TOKAT E TERRITORIT TË KOSOVËS, VETITË PRODUKTIVE, KIMIKE, FIZIKE (UJORO-AJRORE) DHE MËNYRA E SHFRYTËZIMIT TË TYRE

Abstrakt

Në këtë punim do të paraqiten elementet kryesore të relievit të territorit të Kosovës, substratet amë të formimit të tokave të Kosovës, tipat kryesorë të tokave të Kosovës; klasifikimi i tyre për nga aftësitë produktive (klasat bonitative), vetitë fizike, kimike dhe hidrofizike të tyre; mënyra e shfrytëzimit të tokës bujqësore; sipërfaqet e tokës punuese të përfshira me sisteme të ujitjes si dhe të atyre perspektive për përfshirje, vetitë e tyre hidrofizike dhe produktive me klasifikim për nga përshtatshmëria e tyre për ujitje; rajonizimi i territorit të Kosovës për nga mundësitë dhe përshtatshmëria e tokës, klimës, lartësisë mbidetare dhe pozitës për prodhimtari bimorë; degradimi fizik i tokave; degradimi i tokës bujqësore nga ujërat e ndotur dhe ndotësit e tjerë; degradimi i tokës bujqësore nga ndërtimet etj.

Fjalët çelës: toka, vetitë, substrati, klasifikim, rajonizimi, degradimi.

12. Besim Sahiti, Thoma Nasto, Latif Susuri

**UJITJA ME SISTEMIN PIKË-PIKË MUNDËSON
PËRDORIMIN RACIONAL TË PLEHRAVE AZOTIKË
PËR KULTIVIMIN E LAKRËS (*BRASSICA OLERACEA*
VAR. CAPITATA)**

Abstrakt

Objektiv i studimit ka qenë shpërndarja e dozave të ndryshme të azotit nëpërmjet sistemit të ujitjes me pikëlim (pikë-pikë). Sistemi i ujitjes me pikëlim e rrit efektivitetin e përdorimit të plehrave si dhe mundëson përdorimin dhe vendosjen e tyre pranë sistemit rrënjor të bimëve. Në studim janë përdorur sasi të ndryshme të azotit në doza 50, 100, 150 dhe 200 kg/ha. Eksperimenti ka qenë i vendosur në pronën e Shkollës Bujqësore në Prishtinë, me kulturën lakër-koke sipas skemës bllok i randomizuar, me katër variante me nga tri përsëritje, me numër të bimëve 40 për çdo variant. Plehërimi me azot është bërë në dy faza përmes sistemit të ujitjes pikë-pikë: (I) në javën e katërt dhe (II) në javën e tetë pas mbjelljes së fidanëve në fushë. Në këtë eksperiment janë vlerësuar treguesit e ndryshëm morfologjikë, që kanë të bëjnë me prodhimin e lakrës, si dhe janë bërë analiza për përcaktimin e azotit dhe të materies së thatë në kokat e lakrës. Aplikimi i dozave të azotit përmes sistemit të ujitjes pikë-pikë ka pasur ndikim pozitiv në racionalizimin e ujit në përgjithësi dhe në parametrat morfologjikë dhe prodhues të lakrës.

Fjalët çelës: lakra kokë, ujitja pikë-pikë, azoti.

13. Lavdim Lepaja¹, Endrit Kullaj¹, Kujtim Lepaja¹,
Agim Zajmi²

¹Universiteti Bujqësor i Tiranës, Departamenti i Hortikulturës, Kamëz-Tiranë.

²Universiteti i Prishtinës. Fakulteti i Bujqësisë dhe i Veterinarisë, Prishtinë.

EFEKTET E UJITJES “PIKË PIKË” NË KURSIMIT E UJIT DHE PLOTËSIMI I DEFICITIT GJATË VEGJETACIONIT

Abstrakt

Cilësia dhe rendimenti i pemëve janë rezultat i bashkëveprimit të vazhdueshëm të faktorëve të jashtëm të ambientit (klima, toka, masat agroteknike dhe pomoteknike, të cilat i ndërmerr njeriu) dhe të faktorëve të brendshëm (bazës gjenetike të pemëve). Eksperimenti është vendosur në pemishten prej 10h me dardhë të të kultivarit uilliams, ne Budusallc te Klina. Në këtë rajon, shuma mesatare vjetore e reshjeve është 822 mm, ndërsa ajo e vegjetacionit është 366.8 mm, por, me radhitje jo të favorshme gjatë muajve të vegjetacionit (prill-shtator) . Ky fakt imponon nevojën për ujitje për t'i plotësuar kërkesat e plota të pemëve. Eksperimenti është vendosur në pemishten prej 10 ha, ku janë përfshirë 26 radhë me gjatësi prej 90 m, me gjerësi mesatare 40 cm, duke përfshirë sipërfaqen ujitëse prej 936 m². Në punim janë prezantuar rezultatet e ujitjes “pikë pikë” në krahasim me metodën klasike të ujitjes sipërfaqësore. Gjatë vegjetacionit janë kryer 19 ujitje, me ç'rast janë dhënë 237.120 litra ujë, sasi kjo e cila e plotëson deficitin e sasisë së reshjeve gjatë vegjetacionit në formë të shiut. Me këtë teknologji të ujitjes janë arritur rendimente dhe disa parametra të cilësisë së frutave në nivel të mirë për vitin e tretë (vitin e parë të prodhimit) të kultivimit me gjithsej 14.904 kg/1800 pemë apo në mesatare 8.28 kg/pemë.

Fjalët çelës: dardha uilliams, ujitja, sistemi “pikë-pikë”, kursimi i ujit, rendimenti, cilësia.

14. Demë Abazi¹, Bashkim Kabashi²

¹Demë Abazi, hidrosistemi "Ibër-Lepenc" – Prishtinë.

²Kabashi, Universiteti i Prishtinës - Fakulteti i Bujqësisë dhe i Veterinarisë.

REGJIMI I UJËRAVE DHE MENAXHIMI I BURIMEVE UJORE NË TERRITORIN E RRAFSHIT TË DUKAGJINIT (PELLGU I L. DRINI I BARDHË)

Abstrakt

Studimi dhe menaxhimi i resurseve ujore të një vendi ka rëndësi vendimtare për strategjinë e zhvillimit të të gjitha aktiviteteve njerëzore. Në fakt, janë pikërisht resurset ekzistuese ujore të një vendi ato që përcaktojnë mundësitë zhvillimore të tij. Për këtë arsye sigurimi dhe menaxhimi racional i potencialeve ujore të një vendi ka rëndësi primare për zhvillimin e gjithmbarshëm të tij, duke dhënë kahet dhe format e mundshme për shfrytëzimin e tyre në të gjitha aktivitetet zhvillimore të një vendi.

Në këtë punim është bërë një analizë studimore e pellgut të secilit burim, lumë dhe e atij të L. Drini i Bardhë, me sipërfaqet, debitet dhe veçoritë e tyre, duke përfshirë vlerësimin e karakteristikave të pellgjeve individuale, të cilat ndikojnë në gjendjen e pellgut ujëmbledhës. I tërë rajoni i Rrafshit të Dukagjinit (Pellgu i Drinit të Bardhë), pa territorin e lumit të Pllavës, përfshin një sipërfaqe prej 4360 km², ndërsa bashkë me të, rreth 4649 km².

Sasitë mesatare vjetore të ujërave rrjedhës në këtë territor janë rreth 2.2 miliardë m³ ujë. Por, renditja e tyre për nga sasitë rrjedhëse nuk është aspak e favorshme për periudhën e vegjetacionit, ngase lumenjtë ushqehen kryesisht nga reshjet dhe shkrirja e borës. Nga kjo del se gjatë muajve të verës (qershor, korrik, gusht dhe shtator), për shkak të reshjeve tejet të vogla, debia e të gjitha rrjedhave të lumenjve bie në minimum, ndërsa shumë burime dhe rrjedha të vogla shteren tërësisht, gjë që imponon nevojën e akumulimit të satirave vjetore.

Në këtë studim, përveç kërkesave të përgjithshme afatgjate për ujë, janë dhënë edhe mundësitë teknike të sigurimit të tyre.

Fjalët çelës: pellg (sipërfaqe ujëmbledhëse), debi, vegjetacion, potenciale.

15. Sami Kryeziu, Bashkim Korenica, ¹Bashkim Kabashi

¹Universiteti i Prishtinës – Fakulteti i Bujqësisë dhe i Veterinarisë.

NDIKIMI I UJITJES PIKË – PIKË NË RENDIMENT DHE CILËSI TË RRUSHIT

Abstrakt

Shpërndarja e çrregullt e reshjeve, sidomos e atyre gjatë periudhës së vegetacionit, kur kërkesat e bimëve për ujë janë më të mëdha, imponojnë nevojën për ujitje.

Rrushit i tryezës, padyshim, zë vend të rëndësishëm në shujtën e të ushqyerit të njeriut, duke ofruar sasi të kënaqshme të sheqernave, te cilat janë të nevojshme për organizmin e njeriut.

Ujitja e hardhisë së rrushit përbën një faktor të rëndësishëm edhe në furnizimin e hardhisë së rrushit me materie ushqyese nga toka, masë kjo që mundëson rritjen e produktivitetit të saj.

Qëllimi kryesor i hulumtimit ka qenë të çmohet ndikimi i ujitjes në hardhinë e rrushit të tryezës, përmes formës së ujitjes “pikë-pikë”, në rendiment dhe cilësi të rrushit, te varietetet e rrushit të tryezës Afus-ali dhe Hamburg, në kushte agroekologjike të rajonit të Dukagjinit.

Eksperimenti ka qenë i vendosur në vreshtin me frutdhënie të rregullt të moshës 15-vjeçare, në Suharekë.

Eksperimenti si i tillë ka qenë i ndarë: në variantin eksperimental (me ujitje) dhe variantin kontroll (pa ujitje).

Hulumtimet janë kryer gjatë viteve 2008-2009. Rendimenti i rrushit është shprehur në kg/hardhi (cung), dhe kg/ ha.

Nga matjet e bëra, është parë qartë se ujitja ”pikë-pikë” ka ndikuar në mënyre sinjifikante në rritjen e rendimentit dhe të cilësisë së rrushit të tryezës.

Rendimenti i rrushit i varietetit Afus-ali është ngritur për 47.3% në vitin 2008, dhe me 20.6% në 2009, varësisht nga reshjet vjetore dhe shpërndarja e tyre gjatë këtyre viteve.

Te varieteti Hamburg, rendimenti i rrushit është ngritur për 69.9% në 2008, ndërsa me 74% in 2009.

Përfundimisht është konstatuar se ujitja “pikë-pikë” ka pasur ndikim pozitiv në rritjen e rendimentit dhe të cilësisë së rrushit te varietetet e hulumtuara.

Të dhënat e rezultateve janë përlllogaritur dhe përpunuar përmes programit SPS dhe në bazë të analizës së variancës ni faktoriale.

Fjalët çelës: rendimenti, cilësia, rrushi i tryezës, ujitja, varietetet.

SHËNIME

